

URDHËR
Nr. 124, datë 28.9.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KËRKESAT E PËRBASHKËTA TË
PËRDORIMIT TË HAPËSIRËS AJRORE DHE PROCEDURAVE TË OPERIMIT PËR
SHMANGIEN E PËRPLASJEVE AJRORE¹**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, shkronja “ç”, të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurave të operimit për shmangien e përplasjeve ajrore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS**
Edmond Haxhinasto

RREGULLORE

**PËR KËRKESAT E PËRBASHKËTA TË PËRDORIMIT TË HAPËSIRËS AJRORE DHE
PROCEDURAVE TË OPERIMIT PËR SHMANGIEN E PËRPLASJEVE AJRORE**

Neni 1

Përmbajtja e lëndës dhe fushëveprimi

Kjo rregullore përcakton kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurat e operimit për shmangien e përplasjeve ajrore për t'u përmbushur nga:

a) operatorët e avionit referuar në nenin 4 (1), (b) dhe (c) të udhëzimit të ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar me udhëzimin e ministrit nr. 3, datë 13.3.2015, për fluturimet e ndërmarra në, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë; dhe

b) operatorët e avionit referuar në nenin 4 (1) (b) të udhëzimit të ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar me udhëzimin e ministrit nr. 3, datë 13.3.2015, për fluturimet e ndërmarra në hapësirën ajrore mbi territorin e të cilit zbatohet Marrëveshja Shumëpalëshe, ratifikuar në vendin tonë me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian”.

¹ Ky urdhër përafuron rregulloren nr. 1332/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 16 dhjetor 2011 “Për kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurave të operimit për shmangien e përplasjeve ajrore”.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Sistemi për shmangien e përplasjeve ajrore (ACAS)” do të thotë një sistem avioni i bazuar në mbikëqyrjen e radarit sekondar (RSS) me sinjale transponderi e cila operon në mënyrë të pavarur nga pajisjet bazë të tokës, që i jep këshilla pilotit mbi konflikte potenciale me avionë, të cilët janë të pajisur me transpondera RSS;
2. “Sistemi për shmangien e përplasjeve ajrore II (ACAS II)” nënkupton një sistem për shmangien e përplasjeve ajrore, i cili siguron këshillat për zgjidhjet vertikale përveç këshillave të trafikut;
3. “Treguesi i rekomanduar i zgjidhjes (RA)” nënkupton një tregues të caktuar për të rekomanduar ekuipazhin e fluturimit në një manovër me qëllim që të sigurojë ndarjen nga të gjitha kërcënimet ose një kufizim manovrues që synon të ruajë ndarjen ekzistuese;
4. “Treguesi i rekomanduar (TA) i trafikut” nënkupton një tregues i caktuar për ekuipazhin e fluturimit se afërsia e një tjetër avioni është një kërcënim potencial.

Neni 3

Sistemi për shmangien e përplasjeve ajrore (ACAS)

1. Aeroplanët e përmendura në seksionin I të aneksit të kësaj rregulloreje do të jenë të pajisur dhe operojnë në përputhje me rregullat dhe procedurat siç specifikohen në aneks.
2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masa që të sigurojë operimin e avionëve referuar në nenin 1(2)(a) të udhëzimit të ministrit nr. 3, datë 7.2.2011, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar me udhëzimin e ministrit nr. 3, datë 13.3.2015, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në aneks, në përputhje me kushtet e përcaktuara në atë nen.

Neni 4

Dispozitat e veçanta të aplikimit të operatorëve që i nënshtrohen urdhrit të ministrit nr. 92, datë 28.9.2011, që miraton rregulloren “Për harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në aviacionin civil”

1. Duke u shmangur nga dispozitat e OPS 1.668 dhe OPS 1.398 të aneksit III, të urdhrit të ministrit nr. 92, datë 28.9.2011, që miraton rregulloren “Për harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në aviacionin civil”, neni 3 dhe aneksi i kësaj rregulloreje do të zbatohen për operatorët e avionëve të referuara në nenin 1 (a).
2. Çdo detyrim tjetër për operatorët ajrorë, i përcaktuar nga urdhri i ministrit nr. 92, datë 28.9.2011, që miraton rregulloren “Për harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në aviacionin civil”, përsa i përket miratimit, instalimit apo funksionimit të pajisjeve, do të vazhdojë të zbatohet për ACAS II.

Neni 5

Zbatimi

Në rastin e një avioni me një certifikatë individuale të vlefshmërisë ajrore të lëshuar para datës 1 mars 2012, dispozitat e neneve 3 dhe 4 do të zbatohen duke filluar nga data 1 dhjetor 2015.

ANEKS

SISTEMI PËR SHMANGIEN E PËRPLASJEVE AJRORE

(ACAS) II

(Part-ACAS)

Seksioni I - ACAS II Pajisjet

AUR.ACAS.1005 Kërkesa e performancës

- 1) Avionët e mëposhtëm me turbinë do të jenë të pajisur me version logjik 7.1, të ACAS II për shmangien e përplasjes:

a) avionët me një masë maksimale të certifikuar të ngritjes (*take-off*) më të madhe se 5 700 kg; ose

b) avionët e autorizuar për të transportuar më shumë se 19 pasagjerë.

2) Avionët që nuk janë përmendur në pikën (1), por të cilët do të jenë të pajisur mbi një bazë vullnetare me ACAS II, do të kenë version logjik 7.1 të shmangies së përplasjes.

3) Pika (1) nuk aplikohet tek sistemet e avionëve pa pilot.

Seksioni II - Operimet

AUR.ACAS.2005 Përdorimi i ACAS II

1) ACAS II do të përdoren gjatë fluturimit, përveç rasteve kur parashikohet në listën e pajisjeve minimale, siç specifikohet në aneksin III të urdhrit të ministrit nr. 92, datë 28.9.2011, që miraton rregulloren “Për harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në aviacionin civil”, në një mënyrë që u mundëson shenjat (indikimet) RA, të prodhuara për ekuipazhin fluturues kur është zbuluar një afërsi e panevojshme me një tjetër avion, pa frenimin e indikatorit RA (duke përdorur vetëm treguesin TA ose ekuivalentin), e kërkuar nga një procedurë jo normale ose e lidhur me një performacë të kufizuar nga kushtet.

2) Kur një shenjë RA është prodhuar nga ACAS II:

a) piloti fluturues, menjëherë, do të konfirmojë indikacionet e treguesit RA, edhe nëse kjo bie në kundërshtim me një udhëzim të kontrollit të trafikut ajror (ATC), pa rrezikuar sigurinë ajrore të avionit.

b) ekuipazhi i fluturimit, sa më shpejt që lejohet nga ngarkesa e punës, do të njoftojë njësinë e duhur ATC të çdo RA-je e cila kërkon një devijim nga udhëzimi aktual i ATC-së ose leje fluturimi;

c) kur konflikti është zgjidhur, avioni:

i) do të kthehet me përpikëri tek kushtet e pranuar të instruksionit ATC ose të lejuara dhe ATC do të regjistrojë manovrimet; ose

ii) në përputhje me ndonjë ndryshim të lejes së ATC apo instruksionit të nxjerrë.

AUR.ACAS.2010 Trajnimi i ACAS II

Operatorët do të krijojnë procedurat operative të ACAS II dhe programet e trajnimit në mënyrë që ekuipazhi i fluturimit është i trajnuar siç duhet në shmangien e përplasjeve dhe kompetente në përdorimin e pajisjeve ACAS II.

Shkurtimet dhe emërtimet e përdorura sipas Rregullores Europiane (EU) Nr. 1332/2011 :

(ACAS) “*Airborne Collision Avoidance System*”

(ACAS II) “*Airborne Collision Avoidance System II*”

(RA) “*Resolution Advisory*”

(TA) “*Traffic Advisory*”